



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 si dhe nenit 3, 4 dhe 5 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga buxheti i Komunës 15Nr. 011-23133 e datës 06.05.2015, duke vendosur sipas kërkesës së OJQ "OMPAK – Organizata Multietnike e Personave me Aftësi të Kufizuara" – Lipjan, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 1000 € (njëmijë euro), OJQ "OMPAK – Organizata Multietnike e Personave me Aftësi të Kufizuara" - Lipjan, sipas kërkesës së datës 12.01.2016.

Shuma e cekur në paragrafin paraprak i ndahet për ta mbështetur financiarisht për zhvillimin e aktiviteteve si organizatë për persona me aftësi të kufizuara.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2016 pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyren e Kryetarit në xhironlogarinë bankare 1907946619031150 në Banka Kombëtare Tregtare BKT.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara deri në shumën e lejuar, OJQ "OMPAK – Organizata Multietnike e Personave me Aftësi të Kufizuara" - Lipjan duhet të sjellë raportin financiar duke i bashkëngjitur faturat. Raporti dorëzohet në Zyren e Kryetarit – Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore dhe i cili duhet të jetë në përputhje me nevojat e paraqitura në Kërkesë.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëtin do të njoftohet OJQ "OMPAK – Organizata Multietnike e Personave me Aftësi të Kufizuara" - Lipjan

1Nr. 400-1460

Lipjan, më 13.04.2016

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

